

L I G J
Nr. 8669, datë 26.10.2000

PËR REGJISTRIMIN E PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË DHE TË BANESAVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i regjistrimit

1. Regjistrimi synon t'u ofrojë Kuvendit, Qeverisë, njësive të qeverisjes vendore, organizatave ekonomike, shkencore dhe kulturore, si dhe gjithë shoqërisë civile të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit, për analizat private dhe publike të vendimmarrjes, për kërkime shkencore dhe, në përgjithësi, për përmirësimin e njohjes dhe të të kuptuarit nga shtetasit të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror të vendit.

2. Regjistrimi ofron të dhëna për:

- a) numrin dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë rezidente (banuese);
- b) strukturën demografike dhe karakteristikat kryesore të popullsisë;
- c) numrin, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e banesave dhe të ndërtesave, që përdoren për qëllime banimi;
- ç) kushtet e strehimit të popullsisë.

3. Regjistrimi synon të ofrojë të dhëna të besueshme, të cilat do t'u mundësonin organeve përgjegjëse, ligjore hartimin e listave zgjedhore dhe të pasqyronin të rehat më të fundit në regjistrat civilë.

Neni 2

Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon organizimin dhe realizimin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji termat e mëposhtme do të kuptohen kështu:

a) Me "popullsi rezidente" kuptohet popullsia e përbërë nga grupi i individëve, të cilët ditën e regjistrimit ndodhen në territorin e Republikës, si dhe ata që janë larguar për një periudhë prej më pak se një vit.

b) Me "banesë" kuptohen një ose më shumë mjedise, të caktuara për përdorim banimi, që kanë një hyrje të pavarur në rrugë, në kat, në oborr, në taracë dhe që në çastin e regjistrimit është ose janë të banuara ose të përcaktuara për t'u banuar nga një person ose nga një grup personash.

Termtat e tjera, që do të përdoren në procesin e regjistrimit, do të përcaktohen në librin e udhëzimeve.

Neni 4

Detyrimi për t'u përgjigjur

Të gjithë shtetasit, shqiptarë dhe të huaj, me përjashtim të personelit diplomatik të akredituar në Shqipëri, të cilët në çastin e regjistrimit ndodhen brenda territorit të Republikës, janë të detyruar të japin saktësisht të dhënat e kërkuara për regjistrimin, për vete dhe për të afërmit e tyre.

Neni 5

Institucioni i regjistrimit

Regjistrimi organizohet dhe zbatohet nga Instituti i Statistikave (INSTAT) nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit dhe me mbështetjen e komisioneve të regjistrimit, në prefektura dhe të zyrave të regjistrimit në komuna dhe në bashki.

Përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e këtyre organeve përcaktohen në këtë ligj.

Neni 6

Data e regjistrimit dhe periudha e mbledhjes së të dhënave

Çasti i regjistrimit është mesnata e 31 marsit 2001. Mbledhja e të dhënave do të kryhet brenda muajit prill 2001.

Neni 7

Shtrirja e regjistrimit

1. Regjistrimi mbulon të gjitha zonat, urbane dhe rurale, pra kryhet në çdo qytet dhe fshat të territorit të Republikës.

2. Ai përfshin popullsinë banuese, si dhe të gjitha objektet brenda territorit të Republikës, që përdoren për banim, pavarësisht nëse ato janë pronë e luajtshme ose e paluajtshme.

Neni 8

Të dhënat e mbledhura

Të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit ndahen në dy kategori:

a) Të dhënat individuale, identifikuese të personave që janë: emri atësisë, mbiemri, adresa dhe identifikuesit topografikë.

b) Të dhënat strukturore për karakteristikat e ndërtesave, të banesave, grupeve të personave që jetojnë së bashku, si dhe të individëve, të kërkuara për qëllime vetëm statistikore, në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare.

Neni 9

Mbrojtja e të dhënave dhe sekreti profesional

Të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit mbrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. INSTAT-i dhe Ministria e Pushtetit Lokal marrin masat e mëposhtme:

a) Personeli, i cili, nëpërmjet angazhimit në regjistrim, përpunimit të listave zgjedhore dhe pasurimit me të dhënat e fundit të regjistrave civilë, ka njohuri për të dhëna vetjake, i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional në përputhje me ligjin nr.7687, datë 16.3.1993 “Për statistikën” dhe ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Asnjë autoritet publik nuk mund ta shmangë këtë detyrim, në asnjë rrethanë. Shkelja e këtij detyrimi mbetet e dënueshme edhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës me programin e regjistrimit.

b) INSTAT-i dhe Ministria e Pushtetit Lokal marrin masat e duhura teknike, organizative dhe të sigurimit, për të parandaluar çdo hyrje të paautorizuar në vendet dhe instalimet ku ruhen të dhënat e regjistrimit, si dhe për të parandaluar përpunimin e paautorizuar të këtyre të dhënave.

c) Të dhënat e mbledhura për qëllime statistikore, pas kontrolleve teknike për saktësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre, të kryera nga personeli i regjistrimit, bëhen anonime, nëpërmjet fshirjes së të dhënave identifikuese, individuale nga dosjet elektronike.

ç) Të dhënat individuale anonime mund t'i komunikohen një pale të tretë, të autorizuar vetëm për veprimtari që janë në përputhje me qëllimin statistikor të regjistrimit. Marrësi i të dhënave i

nënshtrohet detyrimit të sekretit profesional; merr masat e përshtatshme të sigurimit dhe garanton që çdo botim i rezultateve statistikore të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 10

Rezultatet e regjistrimit

Rezultatet statistikore të regjistrimit janë një pasuri e përbashkët e të gjithë shoqërisë shqiptare. Ato jepen në kushtet e mëposhtme:

a) INSTAT-i paraqet dhe boton rezultatet e përkohshme dhe ato përfundimtare të regjistrimit mbi baza shkencore dhe profesionale.

b) Rezultatet statistikore, në nivel vendi ose njësie të qeverisjes vendore, janë të publikueshme pa kufizime. Megjithatë, ato duhet të paraqiten në një formë, që përjashton çdo mundësi për identifikimin e individëve të veçantë.

KREU II

PËRBËRJA, PËRGJEGJËSITË DHE MARRËDHËNIET E ORGANEVE TË NGARKUARA PËR TË BËRË REGJISTRIMIN

Neni 11

Komisioni Qendror i Regjistrimit

Komisioni Qendror i Regjistrimit përbëhet nga 23 anëtarë, si më poshtë:

- Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale	kryetar
- Ministri i Financave	anëtar
- Ministri i Pushtetit Lokal	anëtar
- Ministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë	anëtar
- Ministri i Drejtësisë	anëtar
- Ministri i Arsimit dhe Shkencës	anëtar
- Ministri i Punëve Publike	anëtar
- Ministri i Transportit	anëtar
- Ministri i Shëndetësisë	anëtar
- Ministri i Rendit Publik	anëtar
- Ministri i Mbrojtjes	anëtar
- Ministri i Punëve të Jashtme	anëtar
- Kryetari i Akademisë së Shkencave	anëtar
- Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it	anëtar
- Kryeregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	anëtar
- Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore	anëtar
- Dekani i Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tiranës	anëtar
- Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës	anëtar
- Përgjegjësi i Sektorit të Demografisë pranë INSTAT-it	anëtar
- Shefi i Departamentit të Statistikave, Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tiranës	anëtar
- Tre specialistë nga fushat e ekonomisë, të informatikës dhe demografisë, të zgjedhur nga Komisioni Qendror i Regjistrimit	anëtarë

Neni 12

Përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Regjistrimit

Komisioni Qendror i Regjistrimit ka këto përgjegjësi:

a) Harton dhe miraton rregulloren e Komisionit Qendror të Regjistrimit.

b) Mbikëqyr përgatitjen dhe zbatimin e regjistrimit dhe udhëzon INSTAT-in për të dhënat statistikore, që priten nga institucionet publike, rrethet shkencore dhe shoqëria civile.

c) Garanton bashkërendimin e punës ndërmjet ministrive dhe institucioneve qendrore për regjistrimin dhe mbështetjen e organizatave shkencore.

ç) I propozon Këshillit të Ministrave përbërjen e komisioneve të regjistrimit në prefektura dhe të zyrave të regjistrimit në bashki dhe komuna, si dhe përcakton detyrat e tyre.

Neni 13

Instituti i Statistikave

Instituti i Statistikave (INSTAT) ka këto përgjegjësi:

a) Harton programin e punës, përcakton metodologjinë, harton pyetësin, përzgjedh mjetet teknike dhe programet kompjuterike të përshtatshme, nxjerr udhëzimet e nevojshme dhe kryen përgatitjen dhe zbatimin e regjistrimit në baza profesionale dhe shkencore të pavarura.

b) Menaxhon burimet njerëzore dhe financiare të ofruara për regjistrimin dhe u raporton Komisionit Qendror të Regjistrimit dhe donatorëve ndërkombëtarë përdorimin e këtyre burimeve.

c) Njofton autoritetet dhe organet qeveritare përkatëse për hapat që duhen marrë për regjistrimin, zhvillon fushatën e njoftimit publik dhe raporton në Komisionin Qendror për zhvillimin e veprimeve të regjistrimit.

ç) Harton termat e referencës dhe udhëzimet e trajnimit që duhen zbatuar nga komisionet e regjistrimit në prefekturë dhe zyrat e regjistrimit, në bashki dhe komuna për përzgjedhjen dhe trajnimin e personelit të regjistrimit. Drejton punën në terren për realizimin e qëllimeve të këtij ligji dhe merr të gjitha masat e nevojshme për kryerjen, në kohë dhe me korrektësi, të regjistrimit, në bashkëpunim me organet e regjistrimit në njësitë e qeverisjes vendore.

d) Paraqet dhe boton rezultatet paraprake dhe përfundimtare të regjistrimit.

Neni 14

Komisioni i regjistrimit në prefekturë

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Komisionit Qendror të Regjistrimit, cakton përbërjen e komisioneve të regjistrimit që ngrihen në çdo prefekturë. Ky komision ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Në zbatim të udhëzimeve dhe përcaktimeve të INSTAT-it organizon punën përgatitore për regjistrimin brenda territorit të prefekturës, përzgjedh personelin e regjistrimit, trajnon kontrollorët dhe merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin në kohë dhe me korrektësi të procesit të regjistrimit.

b) U jep asistencë teknike zyrave të regjistrimit, në bashkitë dhe komunat, brenda territorit të prefekturës dhe bën kontrole periodike në këto zyra për zhvillimin e procesit të regjistrimit.

c) Raporton çdo javë në INSTAT për zhvillimin e veprimeve të regjistrimit në prefekturë, ndërsa gjatë muajit të regjistrimit raporton çdo ditë.

ç) Në bashkëpunim me INSTAT-in dhe me zyrat e regjistrimit, në bashki dhe komunë, organizon punën për marrjen dhe dërgimin e pyetësorëve të regjistrimit dhe të materialeve shoqëruese në komisionet dhe zyrat e regjistrimit në bashki dhe komunë.

Neni 15

Zyrat e regjistrimit në bashki dhe komuna

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Komisionit Qendror të Regjistrimit, cakton përbërjen e një zyre regjistrimi, në çdo komunë dhe bashki. Kjo zyrë ka detyrat e mëposhtme:

a) Në zbatim të udhëzimeve dhe të orientimeve të INSTAT-it merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zhvillimin normal të veprimeve të regjistrimit brenda territorit të bashkisë dhe komunës dhe u jep të dhëna dhe asistencë personelit të regjistrimit në qytete dhe fshatra.

b) Përzgjedh dhe trajnon anketuesit dhe kontrollon kryerjen e detyrave prej tyre.

c) Raporton çdo javë pranë komisionit të regjistrimit në prefekturë për zhvillimin e procesit të regjistrimit brenda territorit të bashkisë ose komunës, ndërsa gjatë muajit të regjistrimit raporton çdo ditë.

ç) Merr masat e duhura për të siguruar pranimin në gjendje të mirë të materialeve të regjistrimit në bashki ose komunë, depozitimin e sigurtë të këtyre materialeve dhe dorëzimin në kohë të tyre në komisionin e regjistrimit të prefekturës.

KREU III PROCEDURAT E REGJISTRIMIT

Neni 16 **Publiciteti**

Qëllimet dhe procedurat e regjistrimit, si dhe detyrimet juridike lidhur me të, do të bëhen publike nëpërmjet mediave dhe një fushate të gjerë njoftimesh të drejtuara nga INSTAT-i. Publiciteti do të fillojë të paktën katër javë para fillimit të regjistrimit.

Neni 17 **Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme**

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme i jep INSTAT-it në kohën e duhur hartat treguese të vendndodhjes së pasurive të paluajtshme.

Neni 18 **Personeli i regjistrimit**

Personeli i regjistrimit përbëhet nga:

- a) anketuesit, të cilët të pajisur me një shenjë dalluese zyrtare, shkojnë në çdo vendbanim për të intervistuar banorët dhe për të plotësuar me saktësi pyetësin;
 - b) kontrollorët, të cilët mbështesin dhe kontrollojnë punën e disa anketuesve;
 - c) mbikëqyrësit, të cilët mbështesin dhe kontrollojnë punën e disa kontrollorëve;
 - ç) operatorët, të cilët fusin të dhënat e pyetësorëve në sistemet e kompjuterizuara;
 - d) personeli drejtues, që organizon dhe drejton përgatitjen, njoftimin, logjistikën dhe administrimin e regjistrimit;
 - dh) statisticienët, demografët dhe personeli tjetër, të cilët përpunojnë të dhënat, analizojnë përmbledhëset dhe nxjerrin rezultatet statistikore të regjistrimit.
2. INSTAT-i përcakton kriteret për përzgjedhjen, rekrutimin dhe trajnimin e personelit të regjistrimit, të cilët emërohen si më poshtë:
- a) Emërimi i anketuesve bëhet nga zyra e regjistrimit në bashki ose komunë.
 - b) Emërimi i kontrollorëve bëhet nga komisioni i regjistrimit të prefekturave, me propozimin e zyrës së regjistrimit në bashki ose komunë.
 - c) Emërimi i mbikëqyrësve bëhet nga komisioni i regjistrimit të prefekturave.
 - ç) Emërimi i operatorëve, i personelit drejtues dhe i ekspertëve shkencorë bëhet nga INSTAT-i.

Neni 19 **Ndalimi për mbledhjen e të dhënave të ngjashme**

1. Gjatë një periudhe kohore prej 6 javësh para kryerjes së regjistrimit dhe gjatë muajit të mbledhjes së të dhënave të regjistrimit është e ndaluar, për të gjithë individët dhe organizatat, të mbledhin të dhëna brenda territorit të Republikës.

2. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, të gjitha subjektet, të cilët gjatë periudhës së përmendur më lart kanë ndërmend të grumbullojnë të dhëna për individë dhe banesa ose për veprimtari tregtare e private, duhet të kërkojnë një autorizim të veçantë pranë Komisionit Qendror të Regjistrimit.

KREU IV KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 20 **Kundërvajtjet**

1. Çdo shkelje e rregullave të parashikuara në nenet 4 dhe 9 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 20 000 lekë.

2. Çdo shkelje e rregullave të parashikuara në nenin 19 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 15 000 deri në 20 000 lekë.

Neni 21

Dënimet me gjobë, për shkelje administrative të parashikuara në nenin 20, jepen nga kryetari i komisionit të regjistrimit në prefekturë. Ankimi kundër këtij dënimi bëhet pranë Komisionit Qendror të Regjistrimit brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit. Kundër vendimit të Komisionit Qendror të Regjistrimit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 10 ditëve.

Procedurat për vënien dhe vjeljen e gjobave rregullohen nga ligji nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

KREU V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 22

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në përputhje me parimet e përgjithshme të parashikuara në nenet 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 të këtij ligji.

Neni 23

Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të mars - prillit 2001 nuk do të përdoren për hartimin e listave zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2780, datë 7.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.